



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

Nr. 894 / prot.

Tiranë, më 30 . 01 . 2026

Lënda: Kualifikimi i mësuesve për vitin shkollor 2025-2026

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE**

Rruga "Mustafa Lleshi", Godina e Thesarit
Tiranë

**Për dijeni: AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Rruga "Naim Frashëri", Nr.37
Tiranë

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Aleksandër Moisiu"
Tiranë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Bulevardi "Zhanë d'Ark", Nr. 23
Tiranë

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të udhëzimit nr. 17, datë 22.07.2024, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë", i ndryshuar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), Qendra e Shërbimeve Arsimore (QShA), drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), zhvillojnë procedurat për organizimin e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.

1. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar të vënë në shërbim të mësuesve programet e kualifikimit brenda datës 30 janar 2026.

Programet mund të gjenden edhe në faqen zyrtare të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

2. Mësuesi që kërkon të kualifikohet, aplikon në SMIP brenda datës 3 shkurt 2026, duke plotësuar rubrikat: ZVAP, vitet e eksperiencës, shkolla dhe shkalla e kualifikimit.
3. Mësuesi i arsimit parashkollor që kërkon të kualifikohet dorëzon në ZVAP-në përkatëse kërkesën për të marrë pjesë në kualifikim, brenda datës 3 shkurt 2026.
4. ZVAP-ja shqyrton dhe miraton kërkesat e paraqitura në SMIP dhe ato të mësuesve të arsimit parashkollor për pjesëmarrjen në procesin e kualifikimit, brenda datës 6 shkurt 2026.
5. Mësuesi, të cilit i është miratuar kërkesa nga ZVAP-i, dorëzon dosjen e tij profesionale brenda datës 12 shkurt 2026.
6. Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve (KVD), i ngritur nga titullari i ZVAP-së, vlerëson me pikë dokumentet e dosjes profesionale brenda datës 20 shkurt 2026.
7. ZVAP-ja harton listat e kandidatëve për provimet e kualifikimit, së bashku me vlerësimet e dosjeve profesionale (sipas formatit të ASCAP), brenda datës 25 shkurt 2026.
8. Pas procesit të ankimit, lista përfundimtare e mësuesve që do të marrin pjesë në provimet e kualifikimit, u bëhet e ditur mësuesve deri më datë 27 shkurt 2026, në mënyrë që secili prej tyre të kontrollojë të dhënat dhe vlerësimet e dosjes së tij. ZVAP-ja dërgon në formë elektronike dhe zyrtare në DRAP-në përkatëse listat e mësuesve që do të marrin pjesë në kualifikim, brenda datës 3 mars 2026.
9. DRAP-ja harton listat përfundimtare për të gjitha ZVAP-të nën juridiksion të saj, sipas formatit të ASCAP-it dhe i dërgon në formë elektronike dhe zyrtare në AKAP, brenda datës 4 mars 2026. Pas kësaj date nuk bëhen ndryshime në listën e mësuesve për kualifikim.
10. AKAP-ja dërgon në QShA listën e mësuesve kandidatë për kualifikimin e kategorisë “Mësues i kualifikuar”, brenda datës 6 mars 2026.
11. QShA-ja publikon kalendarin e zhvillimit të testit të informatizuar sipas profileve përkatëse brenda datës 10 mars 2026. ZVAP-ja vë në dispozicion të kandidatëve kalendarin e QShA-së.
12. Rezultatet paraprake të testit të informatizuar për kategorinë “Mësues i kualifikuar” do të dorëzohen në AKAP nga QShA-ja brenda datës 7 prill 2026.
13. Drejtuesi i institucionit arsimor harton kalendarin dhe organizon procesin e orëve mësimore dhe të orëve të prezantimit të projekteve kurrikulare të hapura për mësuesit e kategorive “Mësues i kualifikuar” dhe “Mësues specialist” gjatë periudhës mars - prill 2026. Kalendari dorëzohet në ZVAP-në përkatëse.
14. ZVAP-ja organizon procesin e zhvillimit të orëve mësimore dhe të orëve të prezantimit të projekteve kurrikulare për procesin e kualifikimit për mësuesit e kategorive “Mësues specialist” dhe “Mësues mjeshtër”. ZVAP-ja, në bashkëpunim me drejtuesit e rrjeteve profesionale, harton kalendarin e zhvillimit të tyre në periudhën mars - prill 2026 dhe e miraton atë për të gjithë kandidatët.
15. Rezultatet e vlerësimit të mësuesve për orën mësimore dhe për orën e prezantimit të projektit kurrikular të hapur për kategoritë “Mësues i kualifikuar” dhe “Mësues specialist” do të dorëzohen në ZVAP nga drejtuesi i institucionit arsimor brenda datës 30 prill 2026.

16. Rezultatet përfundimtare të mësuesve për të gjithë procesin e kualifikimit do të dorëzohen në DRAP nga ZVAP-të brenda datës 12 maj 2026.
17. Rezultatet përfundimtare të mësuesve për të gjithë procesin e kualifikimit do të dorëzohen në AKAP nga DRAP-ja brenda datës 15 maj 2026.
18. Rezultatet përfundimtare të mësuesve për të gjithë procesin e kualifikimit do të dorëzohen në ASCAP nga AKAP-ja brenda datës 19 maj 2026. Mbas kësaj date nuk mund të bëhen ndryshime të rezultateve të kualifikimit.
19. ASCAP-i dhe AKAP-ja organizojnë seanca informuese me DRAP-të dhe ZVAP-të për procedurat e organizimit të kualifikimit të mësuesve për të gjitha kategoritë e kualifikimit.

Duke ju falënderuar,

ZËVENDËSMINSTËR

ORJANA OSMANI

